REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit 021/014/11 Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No: 1793-1/2023
Nr. i fageve Broj stranica No. pages: 7 Data Datum Date: 07.09.2023
Dalëse PRISHTINË/A

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada – Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Ferit Idrizi,** Kryetar i Komunës së Vushtrrisë<br><br>**Melihate Basholli-Latifi,** Kryesues i Kuvendit të Komunës | |
| Kopje: | **Elbert Krasniqi,** Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>**Trim Berisha,** Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | |
| Përmes: | **Resul Makreshi,** Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve<br><br>**Enis Spahiu,** Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | |
| Nga: per | **Klit Shala**, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Datë: 24.08.2023 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor<br><br>2.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor | **Razije Murtezaj**, Zyrtare Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve<br><br>**Kimete Zekaj**, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Referencë: 202/2023 |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim të aktit të Komunës | |
| Lloji i aktit: | **Vendim** | |

I nderuari Kryetar z. Idrizi,
E nderuara Kryesuese znj. Basholli-Latifi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

| |
|---|
| **Vendim Nr 158/23 për financim të përbashkët të projektit " Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq"** |
| *I miratuar më datë 30.06.2023* |
| *I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 06.07.2023* |
| *I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 24.08..2023* |

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Vushtrrisë, jep konstatimet e mëposhtme:

1. Me anë të aktit administrativ të komunës së Vushtrrisë që është subjekt i shqyrtimit, synon financimin e projektit për " Ndërtimin e objektit për nevoja të Kryqit të Kuq" në vlerë të parallogaritur 89,999.09 ( tetëdhjetë e nëntëmijë e nën qind e nën dhjet e nëntë euro e nëntë cent )euro, ku Komuna e Vushtrrisë do të financoj 40% të vlerës së projektit në bashkëfinancim me Kryqin e Kuq ku do të financoj 60% të vlerës së projektit.

2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se procesi i ndryshimeve në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën-programeve evidentohet edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, si por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 (këtej e tutje referuar si 'Ligji i Buxhetit 2023'), Udhëzimet Administrative Nr.04.2029 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2019 për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritizimin e Projekteve Kapitale (këtej e tutje referuar si 'Udhëzimet Administrative').

3. Kështu, në kuptim të projekteve të reja kapitale, neni 16, paragrafi 8, nën paragrafi 8.2 i Ligjit të Buxhetit 2023 përcakton se në rastet e alokimit të mjeteve për projekte të reja kapitale të cilat përfshijnë participim të komunitetit dhe/ose donatorëve, duhet ndjekur procedurat si në vijim:

**Neni 16**
**Ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën-programeve**

8.2. me rastin e participimit të komunitetit dhe/ose donatoreve tjerë në bashkëfinancimin e një projekti në nivel lokal me ç'rast krijohet kod i ri i projektit pas aprovimit nga Kuvendi Komunal, në këtë rast projekti i ri mund të krijohet me fondet nga kodi i projektit për bashkëfinancim bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të komunës dhe komunitetit/donatorëve.

4. Nisur mbi premisat e këtij argumentimi, mbetet evidente se organizata buxhetore ka bërë ndarjen e mjeteve financiare për realizimin e projektit. Përkundër kësaj, realizimi i suksesshëm i një procesi të tillë karakterizohet me detaje teknike buxhetore për të cilat organizatat buxhetore bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Buxhetit.

5. Në këtë kuptim, Ministria konstaton se ligjërisht, Komunave ju mundësohet marrje e vendime të tilla, mirëpo realizimi i suksesshëm i tyre **kushtëzohet** me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit lidhur me Udhëzimet Administrative dhe të ngjashme. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.

6. Në këtë kuptim, Ministria konstaton se **akti administrative i Komunës së Vushtrrisë është në përputhje me legjislacionin në fuqi** - mirëpo realizimi i suksesshëm **kushtëzohet** me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Vushtrrisë dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

***Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve***

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrri,<br>Melihate Basholli - Latifi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë | |
| Kopje: | Elbert Krasniqi, Minister i MAPL<br>Trim Berisha, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Liburn Aliu, Minister i MMPHI<br><br>Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI | |
| Nga: | Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor | Nr. VL-210/23<br>Datë:18.07.2023 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit | |
| Lënda: | Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal | |
| Lloji i aktit: | Vendimin Nr. 158/23 për financim të përbashkët të projektit "Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq", miratuar nga Kuvendi Komunal, datë 30.06.2023. | |

I nderuar kryetar Idrizi,
E nderuar kryesuese Basholli - Latifi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, konstatoi se nuk mund të trajtohet vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit Nr. 158/23 për financim të përbashkët të projektit "Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq, miratuar nga KK Vushtrri, meqenëse me vendimin Nr.152/23 është shfuqizuar vendimi Nr.50/23, datë 23.02.2023 për caktimin e lokacionit për objektin e Kryqit të Kuq, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë .

dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave :

KONFIRMON

Vendimin Nr.153/23 për shfuqizimin e Vendimit Nr. 50/23 të datës 23.02.2023 për caktimin e lokacionit për objektin e Kryqit të Kuq, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, datë 30.06.2023.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të përmbajtjes së Vendimit Nr.153/23 për shfuqizimin e Vendimit Nr. 50/23 të datës 23.02.2023 për caktimin e lokacionit për objektin e Kryqit të Kuq, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, konstatoi se:

Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, ka vepruar në pajtim me vlerësimin e ligjshmërisë nr.prot.3807/23, datë 11.07.2023, së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me të cilin vendimi Nr.50/23 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq, dega në Vushtrri, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, është vlerësuar se është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Vushtrrisë dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
020-578/18
-VI- 24.08.2023

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MFPT | |
| Kopje: | Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Jeton Qela, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 23.08.2023<br>Nr: VI-020-578 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Shkresë përcjellëse për MFPT | |
| Lloji i aktit: | Vendim | |

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, **Vendimin Nr 158/23** për financim të **përbashkët të projektit "Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq "**, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, dhe i nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

**Vendimin Nr 158/23 për financim të përbashkët të projektit "Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq ".**
**I miratuar më datë: 30.06.2023**
**I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2023**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr./Br. 153/23
Nr. i Fq./Br. st. 2
Datë/Datum 30.06.2023
VUSHTRRI - VUČITRN

Republika e Kosovës | Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenin 10 dhe 11 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i Statutit të Komunës, Vendimin e Kuvendit të Komunës 01Nr. për Aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor të vazhduar më 30 qershor 2023, merr këtë:

## VENDIM
## PËR FINANCIM TË PËRBASHKËT TË PROJEKTIT "NDËRTIMI I OBJEKTIT PËR NEVOJA TË KRYQIT TË KUQ TË KOSOVËS DEGA NË VUSHTRRI"

1. Me këtë vendim miratohet financimi i përbashkët i projektit për ndërtimin e objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri në vlerë të parallogaritur 89,999.09 € (tetëdhjetë e nëntëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e nëntë cent).

2. Bashkëfinancimi i projektit nga pika paraprake e këtij vendimi do të bëhet si vijon:

2.2. Komuna e Vushtrrisë do të financoj 40% të vlerës së projektit nga buxheti i vitit 2023/2024 – fondi për bashkëfinancim në Drejtorinë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural;

2.3. Kryqi i Kuq i Kosovës do të financoj 60% të vlerës së projektit.

3. Ndërtimi i objektit do të bëhet në parcelën Kadastrale nr. P-70202016-02253-23 në sipërfaqe prej 500 m² Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

4. Realizimi i këtij projekti do të bëhet brenda vitit 2023/2024.

5. Objekti i cili do të ndërtohet sipas projektit regjistrohet në RDPP në pronësi të Komunës së Vushtrrisë dhe Kryqit të Kuq të Kosovës sipas përqindjes së mjeteve financiare me të cilat kontribuojnë në realizimin e këtij projekti.

6. Kryqi i Kuq dega në Vushtrri do t'a shfrytëzoj objektin për nevoja të veta në afat të pacaktuar dhe pa kompensim.

7. Autorizohet Kryetari Komunës që të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me përfaqësuesin e Kryqit të Kuq në të cilën do të përcaktohen detajet rreth ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave të objektit siç është cekur në këtë vendim.

8. Procedurat e tenderimit për ndërtimin e objektit të përcaktuar në këtë vendim do të zbatohen konform legjislacionit në fuqi.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

01 - 020 - 578/1
11.07.2023

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Izedin Bytyçi, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MMPHI | |
| Kopje: | Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL | |
| Nga: | Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Date: 07.07.2023<br>Nr: VI-020-578 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2. Zyrtari hartues vlerësimit ligjor | Xhevat Tafa, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br><br>Ardita Latifi, Zyrtare e Lartë për monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Shkresë përcjellëse për MMPHI | |
| Lloji i aktit: | **Vendim** | |

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, Vendimin Nr 158/23 për financim të përbashkët të projektit " Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq ", i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, dhe i nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr 158/23 për financim të përbashkët të projektit "Ndërtimi i objektit për nevoja të Kryqit të Kuq ".
I miratuar më datë: 30.06.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2023

9. Mjetet financiare të mbetura pas përfundimit të projektit do të iu kthehen Komunës së Vushtrrisë përkatësisht Kryqit të Kuq bazuar në përqindjen e mjeteve me të cilat kanë participuar.

10. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryqi i Kuq i Kosovës.

11. Ky vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja ($m^2$)<br>Površina ($m^2$)<br>Area ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Shërbimet Publike/Javne Usluge/PublicServices | Aeroport/Aerodrom/airport | | 4303 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Lični broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Përshkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pronësi individuale (Një Pronarë) / Individualno Vlasništvo (1 VL) / Single Owner | Komuna e Vushtrrisë | 600535001 | VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI / | | AHMET KRASNIQI | 1/1 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vushtrri

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70202016-02253-11 | Parcelë / Parcela / Parcel | 4300 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1791

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Datum/Date: 20.02.2023
Koha/ Vreme/ Time: 10:40:25
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature: ____________